

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-23-0038****Në ankesën e****Paditësi/Ankuesi****O Q I**, Prishtinë i përfaqësuar nga Avokati E A, Prishtinë.**Kundër****E paditura****NSH "Ndërtimtari" me seli në Prishtinë (në likuidim)**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-13-0325, të datës 11 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-13-0325, i datës 11 janar 2023.**

3. Lënda së bashku me propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurisë, kthehet në rishqyrtim tek gjyqtari përkatës i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 13 janar 2023, paditësi në bazë të autorizimit dhënë përfaqësuesit të tij A B, e dorëzon një parashtresë në DHPGJS të cilën ai e quan kërkesë për zgjidhjen e kontratës së shitblerjes. Me këtë parashtresë ai kërkon të vërtetohet e drejta e pronësisë për lokalin i cili gjendet në rrugën "...", në aneksin e ndërtesës ku tani gjendet kompania "D" në Prishtinë, Kompleksi Bashkë me këtë parashtresë ai dorëzon kontratën e shitblerjes nr....., datë, një kopje të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.2422/2008, me të cilën kjo gjykatë është shpall jo kompetente për një padi të njëjtë, dhe faturat e lëshuara nga NSH ja.

Me datë 24 prill 2015, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja ka pohuar se padia është parashtuar në kundërshtim me nenin 29 dhe 30 të Ligjit të AKP-së, se paditësi nuk ka prezantuar Autorizimin për përfaqësim në DHPGJS. Tutje AKP-ja pohon se NSH-ja është hyrë në likuidim që nga data 30.05.2011, dhe se duhet të pezullohet procedura lidhur me padinë e paditësit. AKP-ja ka kërkuar që të hedhet poshtë ose të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit.

Me datë 25 gusht 2015, paditësi përmes përfaqësuesit të ri të tij avokatit E A ka dorëzuar një përgjigje në mbrojtjen në padi. Në këtë parashtresë paditësi i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e AKP-së si të pa mbështetura në ligj.

Me datë 25 gusht 2015, paditësi e dorëzon edhe një parashtresë në DHPGJS për rregullim të padisë. Në këtë parashtresë ai ka pohuar se kontrata e shitblerjes është lidhur me datë 01.06.1980 lidhur me lokalin afarist i cili gjendet në lagjen U në Prishtinë e cila ndërtesë ka qenë në ndërtim. Lokali afarist gjendet në, objektin përdhese dhe sipas projektit kryesor është shënuar me numër .. ndërsa në

shemën përdhese me numër.. Tutje Padiësi pohon se kontrata e shitblerjes është përbushur në tërësi nga të dy palët është paguar çmimi dhe ai ka marrë në posedim lokalin e blerë. Në këtë parashtresë ai ka kërkuar që mbi bazën e kontratës së shitblerjes, të vërtetohet e drejta e tij e pronësisë për lokalin e cekur që është në sipërfaqe prej 38,06 m², në emër të NSH "Ndërtimtari" në Prishtinë. Bashkë me këtë parashtresë ai ka dorëzuar autorizimin bartës nga përfaqësuesi i parë A B, prokurën e përgjithshme të dhënë nga vet padiësi për përfaqësuesin e parë A B, si dhe provat që i kishte dorëzuar edhe më herët me parashtresën e parë, por ka dorëzuar edhe dëftesë pagesat e kryera në shërbimin e kontabilitetit shoqëror.

Me datë 25 shtator 2015, AKP-ja e dorëzon kundërpërgjigjen në përgjigjen e padiësit, në të cilën ajo pohon se mbetet pranë të gjitha deklarimeve dhe kundërshtimeve të parashtruara në mbrojtjen në padi.

Me datë 25 gusht 2022, padiësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe kërkon që të caktohet masa e sigurisë dhe ti ndalohe të paditurës që të shes, transferoj, ngarkojë me hipotekë apo ndonjë të drejtë tjetër sendore për lokalin lëndor afarist derisa të vendoset në mërita të padisë. Me këtë parashtresë ai ka dorëzuar të njëjtat prova që i kishte dorëzuar edhe më herët.

Me datë 26 tetor 2022, gjyqtari përgjegjës i lëndës i Kolegjit të Shkallës së I-rë e lëshon një urdhër për padiësin që ai të sjellë një autorizim të vlefshëm të nënshkruar nga vet padiësi, pasi që në shkresa të lëndës është autorizimi bartës i lëshuar Z.A B për E A avokat nga Prishtina.

Ky urdhër është pranuar nga avokati E An me datë 27 tetor 2022, pastaj nga O I 14 dhjetor 2022 dhe 19 dhjetor 2022. Në dosje nuk ka ndonjë dëshmi që është përgjigjur në këtë urdhër.

Me datë 11 janar 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me shumicë votash me Aktvendimin C-III-13-0325, e hedhë poshtë si të pa pranueshme padinë e

paditësit dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Kolegji i Shkallës së I-rë ka arsyetuar se autorizimi bartës i nënshkruar nga një person që nuk është vet paditësi e as anëtar i Odës së Avokatëve, nuk ka vlefshmëri juridike. Tutje Kolegji i Shkallës së I-rë konstaton se paditësit i është dhënë mundësia të evitojë këtë parregullsi për të vazhduar gjykimi lidhur me padinë, mirëpo paditësi dhe avokati që ka pretenduar të drejtën e përfaqësimit nuk i ka përmbushur detyrimet e dhëna përmes urdhrit me shkrim.

Me datë 27 janar 2023, paditësi përmes avokatit E A e ka dorëzuar me postë një ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-13-0325, të datës 11 janar 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet Aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim ose të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi pohon se me Aktvendimin e ankimuar është shkelur neni 182 par.2 pika n) e LPK-së, pasi që ky Aktvendim nuk paraqet arsye për faktet vendimtare lidhur me kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, kurse arsyet e dhëna nuk janë të mjaftueshme dhe në kundërshtim me përmbajtjen e provave të dorëzuara nga paditësi. Paditësi pohon se propozimi për caktimin e masës së përkohshme ka për qëllim jo vetëm sigurimin e kërkesëpadiës por ai ka për qëllim edhe evitimin e keqpërdorimit të kësaj pasurie të paluajtshme nga personat e tretë të papërgjegjshëm. Masa e përkohshme e kërkuar do ti ndalonte edhe konfliktet e mundshme me përmasa të ndonjë gjakderdhje të mundshme. Arsyetimi i gjykatës se paditësit vetëm spekulojnë lidhur me atë se prona mund të shitet, bartet apo ngarkohet me ndonjë detyrim është arsyetim shumë jo profesional dhe si i tillë i paqëndrueshëm, këtë vetëm se akti i regjistrimit në pronësi të një personi fizik apo juridik nuk paraqet bazë juridike ligjore për gëzimin e të drejtës së pronësisë. Tutje paditësi në ankesë pohon se brenda afatit të dhënë në urdhër gjykatës, është dorëzuar me postë me datë 01.11.2022, autorizimi i dhënë nga vet pala paditëse me datë 27 tetor 2022. Meqenëse i autorizuari i paditësit ka vepruar drejtë në bazë të urdhrit të gjykatës të datës 26 tetor 2022, e të pranuar nga posta me 27 tetor 2022, kërkohet nga Kolegji i Apelit të prish Aktvendimin e ankimuar, dhe çështja të kthehet në rigjykim, duke

urdhëruar që lidhur me propozimin për masë të sigurisë të vendoset në procedurë të shpejtuar, sepse paluajtshmëria kontestuese është shpallë për shitje publike nga Komisioni për likuidim.

Me datë 23 shkurt 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Shkallës së I-rë duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregojë fakte të reja apo dorëzojë prova që do të ndikonin në ndryshimin e gjendjes faktike nga ajo që është vërtetuar me Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Shkallës së I-rë. AKP-ja pohon se Shkalla e I-rë vendimin e ankimuar e ka marrë në pajtim me nenin 76.3 të LDHP pasi që është mjaft i qartë dhe përmban shpjegime dhe arsye të mjaftueshme. AKP-ja konsideron se ankesa është paraqitur në kundërshtim me nenin 66 par.1.8 të LDHP-së pasi që i mungojnë argumentet ligjore dhe provat relevante. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Në bazë të nenit 91 të LPK-së përfaqësuesi i palës i cili nuk është avokat, në rastin nëse në prokurë pala nuk ka caktuar më hollësisht autorizimet e përfaqësuesit, përfaqësuesi i palës përveç autorizimeve tjera të përcaktuara me këtë nen, ai ka autorizim edhe "..., për kalimin e prokurës një personi tjetër,...".

Avokati E A me parashtrësën e tij të dorëzuar me 25 gusht 2022 , me të cilin lidhur me pronën lëndore kishte kërkuar nga gjykata caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ai kishte dorëzuar përveç tjerash edhe autorizimin bartës të dhënë nga A B, prokurën e përgjithshme të noterizuar të dhënë për A B, nga vet pala paditëse O I.

Kolegji i Apeli vëren se në Prokurën e përgjithshme në mesin e shumë autorizimeve të dhëna në këtë prokurë, pala paditëse i kishte dhënë autorizim përfaqësuesit të tij të parë A B, që "përfaqësuesin tim e autorizoj që në rast nevojë këtë autorizim të mund ta përcjellë tek personat e tretë apo të ndonjë avokat sipas zgjedhjes së tij". Kjo prokurë e përgjithshme është në dosje të lëndës.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se në bazë të arsyeve të cekura ishte e panevojshme që gjyqtari përgjegjës i Kolegjit të Shkallës së I-rë, të lëshojë urdhër për paditësin dhe përfaqësuesin e tij që të rregullohet çështja e përfaqësimit të paditësit.

Kolegji i Apelit konsideron se është i gabuar dhe nuk ka mbështetje ligjore konstatimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë se "Autorizimi bartës" nuk ka vlefshmëri juridike. Kjo për faktin se vet dispozita e nenit 91 par.1 të LPK-së, jep autorizim përfaqësuesit që nuk është avokat ta bart autorizimin një personi tjetër, e po ashtu në këtë rast është e qartë se edhe në vet Prokurën e dhënë nga pala

paditëse për A B, është dhënë autorizimi shprehimor nga pala paditëse, që përfaqësuesi i tij ka mundësi ta bart autorizimin tek ndonjë person i tretë apo tek ndonjë avokat sipas zgjedhjes së tij.

Andaj në këtë rast në bazë të arsyeve të cekura, nuk mund të konsiderohet si jo ligjor Autorizimi bartës, dhe mund të konstatohet se paditësi O I ligjërisht ishte i përfaqësuar në këtë procedurë në gjykatë, nga ana e avokatit të tij E A.

Prandaj nga këto arsye, Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk mund të qëndrojë si i tillë, andaj ai duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Siç u tha më sipër paditësi me parashtresën e tij të dorëzuar me 25 gusht 2022, ka kërkuar masë të sigurisë, ndërsa me ankesën e tij në shkallën e dytë ai kërkon që në procedurë të shpejtuar duhet të vendoset lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke pohuar se prona lëndore e cila kërkohet me padi është shpall për shitje publike nga komisioni për likuidim.

Andaj është e nevojshme që Kolegji i Shkallës së I-rë në rishqyrtim menjëherë ta trajtojë kërkesën e paditësit për caktimin e masës së sigurisë.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore prej 100 euro me datë 27 shkurt 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
